

Emri	DPK/OMP	Nr. akti	03-1237/13
Nr. akti	02	Data	23.04-2013

KA.nr.167/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Zekaj kryetare, Ramiz Kuqi dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores, Sabahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Arbenita Sadiku , nga fsh. Zaskokë K. Ferizaj, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, shifra 0599 RI nr.11540/2012 të dt.13.11.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 konform neni 222 të Ligjit për kundërvajtjet, më 25.02.2013, merr këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, shifra 0599 RI nr.11540/2012 të dt.13.11.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj, shifra 0599 RI nr.11540/2012 të dt.13.11.2012, të pandehurën Arbenita Sadiku, nga fshati Zaskokë K. Ferizaj, e ka shpallur përgjegjëse: sepse deri me dt. 31.Mars 2012, nuk e ka bërë deklarinimin e rregullt vjetor të pasurisë në cilësinë e këshilltares Komunale të K. Ferizajit , me çka kryen kundërvajtje nga neni 5 dhe neni 6 par. 1 pika 1.2 e ndëshkueshme me nenin 17 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr.04/L-050, në vështrim të nenit 9 par. 1 të LK-së, është dënuar me gjobë në shumë prej 400€.

Me të njëjtin aktvendim e pandehura obligohet që në emër të shpenzime gjyqësore të paguaj shumën paushalle prej 5€.

Kundër këtij aktvendimi e pandehura Arbenita Sadiku , ka paraqitur ankesë për shkak të dënimit me arsyetim se në mbledhjen e dt. 09.03.2012, është e vërtetë se ka marrë pjesë në mbledhje por në fillim të mbledhjes e ka nënshkruar pjesëmarrjen si të gjithë asamblistët dhe ka dalë nga kuvendi për shkak të disa punëve të mia personale-familjare. Me dt.23.08.2012 jam informuar rreth mbledhjes së dt. 09.03.2012, dhe e kam kuptuar se duhet deklaruar pasurinë e kam plotësuar formularin dhe me dt. 24.08.2012, ja kam dorëzuar agjencisë kundër korrupsionit. Propozon që të rishqyrtohet përcaktimi i dënimit, dhe të anulohet gjoba.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, si dhe shkesat tjera të lëndës dhe konstatoi sipas detyrës zyrtare se ankesa e paraqitur është e bazuar kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesë, aktvendimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës konstatoj sipas detyrës zyrtare se ankesa e paraqitur e është e bazuar për shkak se: diapozitivi i aktvendimit të goditur është konfuz dhe i paqartë me vetveten dhe në raport me arsyetimin e tij. Andaj si i tillë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale përkatësisht në shkelje të nenit 205 al.1 pika 1 të LK-së sepse: Përshkrimi i veprës kundërvajtëse me të cilën ngarkohet e pandehura nuk është adekuat me dispozitat në bazë të cilave ajo është shpallur përgjegjëse dhe është dënuar nga se neni 17 par. 1 pika 1.2 të Ligjit nr.04/L, - 050, parasheh përgjegjësin dhe sanksionin në rastet kur personi nuk e bënë deklarin e pasurisë **me rastin e marrjes së detyrës zyrtare**, kurse veprimet inkriminuese të përshkruara në diapozitivin e aktvendimit të goditur se **"Nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë"** e bëjnë diapozitivin kundërthënës që do të thotë se dispozita sanksionuese dhe përshkrimi i veprës janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Nga ana tjetër e pandehura sipas kërkesës për hapjen e procedurës kundërvajtëse ngarkohet me nenin 6 par.1.3 dhe 17 par. 1.3 i cili e sanksionon **mosdeklarimin pasurisë me kërkesë të agjencisë** që do të thotë se gjykata e shkallës së parë nuk iu ka përmbajtur kërkesës për hapjen e procedurës kundërvajtëse gjë që paraqet shkelje të nenit 134 al.1 të LK-së. Nga të cekurat më lartë rezulton gjithashtu se edhe arsyetimi i aktvendimit të goditur është konfuz dhe i paqartë.

Për arsyet e cekura më lartë aktvendimi i goditur është i paqëndrueshëm për shkak se përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, andaj si i tillë është abrogohet kurse lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje. Duke marrë parasysh të cekurat më lartë edhe gjendja faktike ka mbetur e pavërtetuar.

Në plotësim të procedurës Gjykata e shkallës së parë, duhet të kryej këto veprime procedurale: që ta ftoj në mënyrë të rregullt parashtruesin e kërkesës dhe ta merr në pyetje me procesverbal për të dhënë sqarime se për cilin lloj të mosdeklarimit të pasurisë e ngarkon të pandehurën, se për cilën periudhë-kohë dyshohet se ajo e ka kryer kundërvajtjen, sipas nevojës të nxjerrë edhe prova tjera dhe pas eliminimit të shkeljeve esenciale të theksuara më lartë dhe pas vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj, duke marrë për bazë edhe pretendimet e paraqitura në ankesën e parashtruar.

Konform të nenit 222 të Ligjit për kundërvajtjet, u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankese.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS.

AK.nr.167/2013 të dt.25.02.2013

Procesmbajtësja

Sebahate Hoti

KRYETARJA E KOLEGJIT,

Mejreme Zekaj

